

# MUHARREM GASHI

## ASPEKTE TË KONTRIBUTIT TË ALBANOLOGËVE TË HUAJ NË STUDIMIN E TË FOLMEVE TË PRIZRENIT DHE RRETHINËS

811.18'282(497.11)

**Abstrakti:** Në kuadër të studimeve gjuhësore, më 1902 u botua *Fjalori serbokroatisht-shqip*, me rreth 4 mijë fjalë e 1187 pyetje-përgjigje, por gjuha e fjalorit nxiti gjuhëtarët. H. Agani në studimin: *Cila është treva gjuhësore e Fjalorit të L. Kujunxhiqit*, më 1954 veçoi gabime që ky fjalor keqinformoi edhe gjuhëtarë të njohur. Pikërisht ndikimi i shqipes e bëri serbokroatishten e Rahovecit *gjuhë të përzier*, ndërsa leksiku i fjalorit kap të folmen e Rahovecit, atë të qytetit të Prizrenit e më pak atë të qytetit të Gjakovës. Këtu kemi kalimin e-ë-së në *a*, të ë-së në *u* në prapashtesat *-shëm* dhe *-llëk*, përdorimi i *ll*-së në vend të *dh*-së, rënia e shtegores *h* etj. Në njohjen e këtyre të folmeve shquhen N. Jokli, J. Thumanne, H. Pedersen, G. Vajgandi etj., megjithëse *njohja e gjuhës shqipe në gjendjen e atëhershme, ishte më kryesore*. S. Mlladenovi, më 1925 vizitoi zonën midis Prizrenit dhe Prishtinës, nga botoi artikullin: *Vërejtje mbi shqiptarët dhe shqipen në Maqedoninë Veriore dhe në Serbinë e Vjetër*. Më vonë M.Lambretzi do të japë disa karakteristika të dialekteve të gegërishtes lindore ku bëjnë pjesë edhe të folmet e qytetit të Prizrenit. Albanologëve të huaj u mungoi njohja e gjuhës shqipe, ndërsa disa dijetarë sllavë kishin qëllime hegjemoniste, si: M. Pavllloviq e G. Elezoviqi etj.

**Fjalë kyçe:** qark, trajtim, studim, fjalor, e folme etj.

### Aspects of Contribution of Foreign Albanians to the Study of Prizren and Surroundings

Within the language studies, in 1902 Serbo-Croatian Dictionary was published, at about 4,000 words and 1187 questions-answers, but the language of the vocabulary prompted the linguists. H. Agani in the Study: *What is the language language of L. Kujunxhiq's Dictionary*, in 1954 he mentioned mistakes that this dictionary misinformed well-known linguists. The influence of the Albanian language made Rahovec Serbo-Croatian a *mixed language*, while the lexic of the vocabulary gets speech of Rahovec, of the city of Prizren and less that of the city of Gjakova. Here is the passage of *ë* to *a* and to the *u* in the suffixes *-shëm* and *-llëk*, the use of *ll* in place of *dh*, the fall of the hover *h* etc. In recognition of these speeches, they are distinguished by N. Jokli, J. Thumanne, Pedersen, Vajgand, etc., although the recognition of the Albanian language in these circumstances was the most important. S.Mladenovi visited the area between Prizren and Pristina in 1925, from the article: *Remarks on Albanians and Albanians in Northern Macedonia and Old Serbia*. Later, M.Lambretz will give some features of *eastern gege dialect*, which also include the spoken language of the city of Prizren. Foreign Albanlogs lacked the knowledge of the Albanian language, while some Slavic scholars had hegemonic goals, such as: M. Pavlovic and G. Elezović, etc.

**Key words:** qark, trajtim, studim, fjalor, e folme etc.

### Hyrje

Gjuhësia shqiptare për sa i përket aspektit të studimit të dialekteve të shqipes, në këtë kuadër edhe të të folmeve verilidore të dialektit të veriut, ku bëjnë pjesë edhe të folmet e Prizrenit me rrethinë ka arritur rezultate të rëndësishme, ndonëse jo të mjaftueshme. Sfera e studimit të materialit dialektor padyshim se nuk mund të ndahet prej vetë kushteve dhe mundësive përkatëse, ngase diku ka pasur kushte më të mira

hetimi e diku nuk ka pasur. Kjo kryesisht nënkupton materialin e hetuar në fazat para, nga studimet dukshëm ndryshojnë, jo vetëm për nga rezultatet, por edhe për nga vetë metodologjia e përdorur<sup>1</sup>. Në këtë hulli studimet e të folmeve të Prizrenit dhe rrethinës janë pasuruar,<sup>2</sup>madje edhe me monografi, si për të folmen e Hasit<sup>3</sup>, për të folmen e Anadrinit<sup>4</sup>, pastaj me punime të veçanta shkencore për të folmen e Kabashit të Prizrenit<sup>5</sup>, atë të folmen e Zhurit<sup>6</sup> të Prizrenit, të folmen e qytetit<sup>7</sup> të Prizrenit<sup>8</sup>, trevën e Malësisë së Vërrinit të Prizrenit<sup>9</sup>. Gjithashtu vlen të theksohen përimtimet studimore të cilat i shquan fillet e para të identifikimit të tipareve dialektore<sup>10</sup>, tutje po në këtë aspekt punë e mirë është bërë në mbledhjen e leksikut<sup>11</sup> të këtyre të folmeve si dhe përpilimin e fjalorëve dialektorë<sup>12</sup> etj. Padyshim se në bazën e suksesve të përgjithshme të studimeve edhe në këto areale prin për të mbarë në krye të këtyre të arriturave ADGJSH-ja<sup>13</sup>

\*\*\*

Shkrimet e shekujve të kaluar ndihmojnë shumë për të ndjekur fillimin e zhvillimit të dukurive të ndryshme dialektore. Në kuadër të të folmeve të Kosovës, përveç veprës së P. Bogdanit “Çeta e profetëve”, “Doktrinës së krishterë” të Gj. N. Kazazait, “Vebihjes” së T. Boshnjakut dhe “Divanit” të Sheh Maliqit, një përpjekje e mirë që ka ndihmuar në përshkrimin sa më të plotë të veçorive fonetiko-fonologjike dhe identifikimin e pasqyrimin të zhvillimit të dukurive të ndryshme jo vetëm gjuhësore të së folmeve të Prizrenit<sup>14</sup> dhe rrethinës së tij është “Fjalori serbokroatisht-shqip”, që u botua më 1902, me autor L. Kujunxhiqin. Në këtë kontekst gjuhësor është përmbytja e fjalorit serbokroatisht-shqip e L. Kujunxhiqit. Materialin e mbledhur gjuhësor ai ndan në dy shtylla që kapin rreth katër mijë fjalë e lidhje fjalësh, ku janë dhënë ditët, stinët e muajt e vitit, anët e botës, numërorët, kurse në faqet e fundit shtohen ushtrime për të mësuar gjuhën e të folurit me 1187 pyetje-përgjigje të përpiluara me fjali të thjeshta e me fjalitë të zgjeruara. Mirëpo, çështja se mbi cilat areale të të cilave të folmeve është gjuha e këtij fjalori, shtoi interesimin e dialektologëve. Pikërisht për këtë edhe studiuesi, H. Agani, *Fjalorit serbisht-shqip* të L. Kujunxhiqit do t'i qaset ta shqyrtojë në monografinë e tij prej mëse 300 faqesh.

I nxitur nga kureshtja gjuhësore, H. Agani këtë pikëpamje për herë të parë do ta shpërfaqë në punimin e tij të diplomës: “Disa veçori fonetike e morfologjike që ka e folmja e Gjakovës”, më 1954. Dyshimin e përmendur më sipër ai do ta arsyetojë duke e përcaktuar edhe më saktë trevën gjuhësore të Fjalorit të L.

<sup>1</sup> Beci, B. *Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe sistemi fonetik i së folmes së Shkodrës*, Tiranë, 1995, f. 9.

<sup>2</sup> Ajeti, Idriz: “Studime Gjuhësore në Fushën të Shqipes”, I, Prishtinë, Rilindja, 1989.

<sup>3</sup> Badallaj Imri: “E folmja e Hasit”, Prishtinë, 2001.

<sup>4</sup> Pajaziti Naser: “E folmja e Anadrinit”, Prishtinë 2008.

<sup>5</sup> Halimi, M. “E folmja e Kabashit të Prizrenit”, “Kërkime. Dialektologjike.”, Prishtinë.

<sup>6</sup> Badallaj, Imri: “Disa veçori fonetike të së folmes së Zhurit” GJASSHF, V-1975, Prishtinë. 1976; “Nyjat në të folmen e Vërrinit”, Seminari i XXI Ndërkombëtar për GJLKSH, Prishtinë, 2002.

<sup>7</sup> Topçiu, Vedita: “Veçoritë fonetike të së folmes së elemntit katolik të qytetit të Prizrenit”, Punim i mbrojtur i Magjistraturës në FF të UP në Degën e Gjuhës shqipe, Prishtinë, 1988.1978.

<sup>8</sup> Topalli, Mehmet: “Sistemi fonetik i të folmes shqipe të qytetit të Prizrenit”, FF i UP, Dega e Gjuhës shqipe, Prishtinë, 1980.

<sup>9</sup> Zymberi, Abdullah: “Sistemi foljor në të folmen e fshatit Struzhë të Malësisë së Prizrenit”, SNGJLKSH, 2. Prishtinë, 1978.

<sup>10</sup> Bardhi, Medi: “Disa veçori karakteristike në vokalizimin e së folmes së Hasit” SGJ, II, (Dialektologji), Prishtinë, 1979; Luboteni, G. “Ndryshimet më të qensishme dialektore ndermjetegnishtes dhe toskënishtes”, “Përparimi”, X, Prishtinë, 1960.

<sup>11</sup> Topalli, M. “ Fjalë e shprehje të rralla të shqipes”, “Jehona”, Shkup, 6/1978, XVI;

Zymberi Abdullah, „Nga leksiku i Hasit të Prizrenit“, „Toponimia e fshtrave Kojush dhe Plane“, „Toponimia fshatit Mazrek“, „Gjurmime albanologjike“ V-75, Prishtinë, 1976.

<sup>12</sup> Zymberi, Abdullah: “Fjalor i fjalëve të rralla”, Prishtinë, 1979;

Zymberi, Abdullah: “Fjalor popullor: me rreth 20000 fjalë”, “Grafbeni”, Prishtinë, 2014.

<sup>13</sup> ASHSH IGJL “Atlasi Dialektologjik i Gjuhës Shqipe”, Universiteti degli Studi di Napoli L’Orientale, Itali, Vëllimi i I-rë, 2007; Vëllimi i II-të 2008.

<sup>14</sup> Pajaziti N., *E folmja e Anadrinit*, Prishtinë, 2008, f. 21.

Kujunxhiçit në studimin: “Cila është treva gjuhësore e Fjalorit të L. Kujunxhiçit”, të botuar në dy pjesë në revistën “Gjurmime albanologjike”. Po në këtë aspekt, autori i monografisë duke dhënë të dhëna për autorin, botimin e veprës përfshin në trajtesë edhe një numër gabimesh që L. Kujunxhiçi i bëri në shkrimin e trajtave të ndryshme të fjalëve, të cilat edhe e keqinformuan një numër gjuhëtarësh të njohur, të cilët për shpjegime të dukurive të ndryshme gjuhësore përzgjedhën shembuj nga ky Fjalor. Nga trajtimi i hollësishëm që i bën studiuesi ynë fjalorit të Kujunxhiçit shquan mendimin se ndikimi i shqipes mbase e bëri serbokroatishten e Rahovecit “gjuhë të përzier”<sup>1</sup>. Në përcaktimin e trevës gjuhësore të këtij Fjalori, F. Dulaj, duke u mbështetur mbi bazën e studimeve të I Ajetit e të H. Aganit si dhe studimit të të folmeve të Rahovecit me rrethinë shquan se kjo çështja për këto të folme mund të pranohet vetëm si e pjesshme<sup>2</sup>. Studimi “Cila është treva gjuhësore e Fjalorit të L. Kujunxhiçit” i H. Aganit, e shqyrton sistemin tingullor në fonetikë, aspektet e kategorive gramatikore në fushën e morfologjisë: emrin, foljen etj., dhe më pas, të njëjtat duke i krahasuar me të dhëna e autorëve të këtyre anëve, si: P. Bogdanit, Gj. N. Kazazit, T. Boshnjakut e të Sheh Maliqit, gjegjësisht rrah një numër të konsiderueshëm dukurish dialektore me vlera dalluese ndërmjet të folmeve të gegërishtes verilindore e me theks të veçantë të arealeve të të folmeve të Prizrenit dhe rrethinës së tij. Më tutje, në këtë aspekt autori arrin në përfundim se Fjalori i Lubomir Kujunxhiçit pasqyron shqipen e një treve të gjerë që kap të folmen e Rahovecit, pastaj të folmen e qytetit të Prizrenit bashkë me atë të elementit katolik të këtij qytetit, e në raste të veçanta edhe me elemente të caktuara të së folmes së qytetit të Gjakovës”<sup>3</sup>.

Nga dukuritë që spikasin shquhet kalimi i *ë*-së në *a* (mjeshhtar, nesar), i *ë*-së në *u* në prapashtesat *-shëm* dhe *-llëk* ( i djeshum, axhamilluk), përdorimi i zanores *u* dhe *i* në vend të asajj: (babaxhush, çumur, xhuzlluk<sup>4</sup>; çilim, bilmet, hizmet) etj. Tutje po në këtë aspekt përdorimi i *ll*-së në vend të *dh*-së, rënien e shtegores faringale *h* në të tri pozicionet e fjalës, mosdallimin në të shkruar të bashkëtingëlloreve *r* e *rr*, ngase në Rahovec dëgjohej vetëm *r*, e ndonjë element tjetër.<sup>5</sup>

Ndërsa në fushën e morfologjisë shënon pikëtakimet me të folmen e Fjalorit me arealet e së folmes së Rahovecit: shumësin e emrave (atkinj, podkon), përdorimin e variantit të mbaresës së vetës së parë njëjës në disa folje me temë në bashkëtingëllore e me zanore të temës që këmbëhet (*un flasi, un mari*) etj. Në përimtim të lëndës që sjell Fjalori, me gjithë gabimet që janë pasqyruar në trajtimin e përmbajtjes së fjalësit, aspekteve të dukurive që janë shqyrtuar, saktësinë e tyre, hetohet prirja për të shprehur konsiderata për kohën, ose një fillësë të trajtimeve gjuhësore në mes të këtyre arealeve të të folmeve, sado modeste qoftë edhe kjo. Në anën tjetër monografia e H. Aganit: *Fjalori i Lubomir Kujunxhiçit* epasuron fushën e dialektologjisë e të leksikografisë shqipe duke sjellë elemente e të dhëna të studimit të grupit të të folmeve të gegërishtes verilindore, gjegjësisht vëzhgimime tyre pa hyrë në strukturën analizave të thella të të folmeve të arealeve të Prizrenit me rrethinë si dhe të folmeve të afërta me të cilat përkufizohet treva e këtyre arealeve, si me atë të Gjakovës si dhe atë të së folmes së Rahovecit.

Hullia e kërkimit të mirëfilltë të dialektologjisë shqiptare fillon në mesin e shekullit XIX, kur edhe zgjohej kërkësoria e gjuhëtarëve të huaj, në mesin e të cilëve mund të përmendim, së pari, hetimet përnjohëse të gjuhëtarëve gjermanë. Hapat e parë në njohjen e të folmeve të kësaj zone i ka bërë N. Jokli, i cili ka kushtuar kujdes të posaçëm sistemit rasor të shqipes në aspektin e zhvillimit historik,<sup>6</sup> ndërsa

<sup>1</sup> Agani, H. *Cila është treva gjuhësore e Fjalorit të L. Kujunxhiçit*, “GJASSHF”, 1, 2 1969, Prishtinë, f. 54.

<sup>2</sup> Dulaj, F. *E folmja e Rahovecit me rrethinë*, Prishtinë, 2016, f. 296.

<sup>3</sup> Gosturani, XH. *Dr. Hilmi Agani, Fjalori i Lubomir Kujunxhiçit*, Prishtinë, 1981, f. 380, “Studime Filologjike”, nr. 4, 1988, Tiranë, f. 159.

<sup>4</sup> Dulaj, F. *E folmja e Rahovecit me rrethinë*, Prishtinë, 2016, f. 95.

<sup>5</sup> Agani, H. *Fjalori i Lubomir Kujunxhiçit*, Prishtinë, 1981, f. 93.

<sup>6</sup> Norbert Jokl: “Beitragelbanishen Grammatik”, I, IF, 30, 1912, II., 36, 1916.

më 1915 botoi “Njoftim i përkohshëm për studimet e dialekteve të gegërishtes verilindore të bëra sipas porosisë së Komisionit Ballkanik të Akademisë Perandorake të Shkencave në Vjenë”<sup>1</sup>.

Pastaj në këtë aspekt, në hulumtimin mbi letërsinë e popujve të Evropës Lindore, J. Thumanne Hulumtime mbi historinë e popujve të Evropës Lindore”, të botuar në Lajpcig (1774), sidomos në kapitullin ku trajtohet historia dhe gjuha e shqiptarëve shquan në mënyrë të drejtë gjuhën dhe popullin shqiptar: pasardhës të Ilirisë dhe ilirishtes. Po në këtë hulli të këtij paqyrimi ngjashëm do të veprojnë edhe Vajgandi (G.Weigand)<sup>2</sup>, Jokli, Lambreci, megjithëse “njohja e gjuhës shqipe në gjendjen e atëhershme, si duket ishte më kryesore dhe më e ngutshme për shkencëtarët, të cilët, në mungesë të burimeve të mjaftueshme gjuhësore bënë studime krahasuese të gjuhës, prandaj edhe shumë pak u është kushtuar kujdes çështjeve filologjike të gjuhës e veçanërisht dialektologjisë së saj”<sup>3</sup>. Në kuadër të trajtimit të bashkëtingëlloreve shtegore të shqipes që janë pjesë edhe këtyre të folmeve, përkatësisht mendimeve të shprehura nga gjuhëtarët Meyer, Miletij etj. rreth ekzistencës së fonemave shtegore të l-së në gjuhën shqipe, I Ajeti mbi bazën e mendimeve të Holger Pedersenit do t’i trajtojë varietet e këtyre fonemave në studimin e tij: “Tipat e l-së në dialektet shqiptare të Brisk-Shestanit të Krajës”, nga do të rezultojë studimi se në gjuhën shqipe nyjëtohen dy tipa të fonemave shtegoreve: *l* e *ll*.<sup>4</sup>

Në kuadër të Evropës Juglindore këtu duhet përmendur edhe një numër gjuhëtarësh, kryesisht sllavistë, të cilët, në gji të njohjes së disiplinave të ndryshme ballkanike, shfaqin edhe konsideratat për njohjen e gjuhës shqipe. Ndër këta veçohen J. Kopitari, dhe më pas, studenti i tij, slloveni, F. Mikloshiç për përpjekjet pasqyruese në vëllimin: “Kërkime të gjuhës shqipe”(1870). Më tutje H. Bariç shquan konsiderata për gjuhën dhe kulturën shqipe duke e përkrahur mendimin e drejtë se çështja e hundorësisë në gjuhën shqipe është proces i brendshëm i gjuhës shqipes, në vëllimin: “Hymje në historinë e gjuhës shqipe”<sup>5</sup>. Por ndesh këtij mendimi të drejtë ka pasur edhe gjuhëtarë që shtrirjen e fenomenit hundorësisë në gegërishte e kanë shquar të huazuar nga gjuha rumune, si A. Balota.<sup>6</sup> Gjithashtu po në këtë kontekst për sa i përket çështjes së hundorësisë, I. Badallaj, në monografinë “E folmja e Hasit”, shprehet se nuk duhet të tumiret mendimi i V. Cimohovskit se zanoret hundore gjithmonë dalin të gjata, ngase: “në të folmen e Hasit, por edhe në disa të folme të tjera të gegërishtes disa zanore hundore shqiptohen me gjatësi të shkurtër: *ã*°sht, *njã*° etj”.<sup>7</sup>

Për njohjen e kësaj treve ka bërë përpjekje shkencëtari bullgar, S. Mlladenovi. Në gusht dhe në fillim të shtatorit të vitit 1916, Mlladenovi e ka vizituar Maqedoninë Veriore e në mënyrë të veçantë zonën midis Prizrenit dhe Prishtinës, ai për këto të folme përzgjedhi subjekte dialektologjike në qytete e në rrethina të këtyre arealeve.

Më 1925, ai botoi artikullin: “Vërejtje mbi shqiptarët dhe shqipen në Maqedoninë Veriore dhe në Serbinë e Vjetër”. Në artikullin në fjalë jepen disa veçori kryesore fonetike të të folmeve të shqiptarëve të rrethinave të Kaçanikut, Tetovës si dhe të disa rrethinave të tjera, por me një besueshmëri të cekët. „Mendoj se studimi i zënë ngoje i sllavistit të Sofjes, Mlladenovit, është një vështrim i shkruar pa thellësinë dhe njohjen e nevojshme, vende-vende edhe duke u përqendruar në veçoritë e përgjithshme të

<sup>1</sup> Jokl, N. “Vorläufiger Bericht über die im Auftrag der Ballkan- Kommission der Kais. Akad. der Wiss”, in Wien. Phil-hist Kl. , 52, 1915. IG.Von Hahn:”Albanische Studien”, Jena, 1954;

<sup>2</sup>Weigand, G. ”Der Gegische Dialekt von Borgo Erizzo bei Zara in Dalmatien, Jahresbericht des Instituts für Rummanische Sprache“, Leipzig, 1911, f.17.

<sup>3</sup> Ajeti, I. ”Vepra”, I, Prishtinë, 1997, ASHAK, f. 9.

<sup>4</sup>BadallajImri: “E folmja e Hasit”, Prishtinë, 2001, f. 90.

<sup>5</sup> Bariç, H. “Hymjenë historinë e gjuhës shqipe”, Prishtinë, 1955, f. 68.

<sup>6</sup>Balota, A. “La nasalisation et le rhotacism dans les langues roumaine et albanaise”, Bukuresti, 1925, f. 24.

<sup>7</sup>Badallaj, I. “E folmja e Hasit”, Prishtinë, 2001, f. 31.

të folmeve shqipe të Maqedonisë dhe të Kosovës, pa u vënë në spikamë tiparet kryesore të të folmeve, nuk dimë asgjë për kuantitetin dhe kualitetin e zanoreve, e nuk ceket as hundorësia e tyre”<sup>1</sup>.

Në trajtesën *Çështje të zhvillimit të shqipes letrare në Kosovë*, të botuar në vëllimin e katërt të, SNGJLKSH (1995), autori, F. Raka, veçon me të drejtë një përpjekje më të përmblodhur për disa veçorive fonetike, si për shembull: dëgjimi jo i mirë i grykores *hashtu* si edhe në mbarë të folmet e gegërishtes lindore<sup>2</sup>, pastaj rreth veçorivemorfologjike si dhe të ndonjë shënimi tjetër leksikor të C. Tagliavinit në punimin: “Të folmet shqipe të tipit të gegërishtes lindore (Dardania dhe Maqedonia Veriperëndimore), të botuar, më 1942, ku spikatet të dallohen të folmet e gegërishtes lindore nga të folmet e Kosovës, të cilat i përkasin të folmeve të gegërishtes qendrore<sup>3</sup>.

Megjithëkëtë, po në këtë kontekst, vetë Karl Taliavini (C.Tagliavini) do të shprehet qartë: “Hulumtimi ynë, natyrisht ka karakter krejtësisht provizor meqë ai bazohet në materialet e shtypit gjer atëherë ekzistues, të varfër e me vlerë të ndryshme. Mund të thuhet me siguri se të dhënat e “Atlantit linguistik të shqipes” do të mund ta modifikojnë në mënyrë të konsiderueshme konkluzionet e studimit tonë, i cili pikërisht për kërkesë të materialit kufizohet për të dhënë ndonjë karakteristikë fonetike të të folmeve të gegërishtes lindore, duke shënuar vetëm disa karakteristika morfologjike si dhe ndonjë leksikore”<sup>4</sup>.

Tutje në këtë kontekst janë të pambështetura konstatimet e C. Tagliavinit si dhe ato të M. Lambrecit se të folmet e krahinave perëndimore të Maqedonisë të përfshihen në një grup me të folmet e Kosovës t’i përkasin grupit lindor të gegërishtes veriore do të shprehet B. Beci<sup>5</sup>. Gjashtë vite më vonë M.Lambretzi<sup>6</sup>, duke folur për dialektet e shqipes do të bëjë përpjekje të japë disa karakteristika të dialekteve “të gegërishtes lindore” (*Pejë, Deçan, Gjakovë, Prizren, Tetovë, Vrapçisht, Gostivar, Galiçnik, Dibër, Vuçitërn, Prishtinë, Shkup*), por prapë nuk do të largohet në kuadër të të dhënave të K.Taliavinit. Natyrisht se krahas këtyre pasqyrimeve do të kemi vlerësime që edhe sot e kësaj dite qëndrojnë, kështu për shembull shquhet mendimi i gjuhëtarit Burgman, i cili e argumenton shkencërisht ekzistimin e mënyrës dëshirore në të gjitha gjuhët indoevropiane, “apo siç thoshte ai në gjuhët indogjermane”, do të saktësojë I. Badallaj në monografinë për të folmen e Hasit, kur e trajton përimtimin e zhvillimit të historisë së mënyrës dëshirore<sup>7</sup>.

Fazën e parë të gjurmimit të studimeve dialektore, siç edhe po shihet e karakterizon kryekëput, siç edhe është shprehur J. Gjinari në vëllimin “Dialektologjia”, pra mungesa e studimeve të mirëfillta të të folmeve të gegërishtes verilindore, prej këndeje rrjedhimisht edhe të arealeve të të folmeve të qytetit të Prizrenit dhe të rrethinës së tij. Megjithëse do të ishte krejt e pafalshme nëse nuk do të vlerësojmë ndihmesën e studimeve të kësaj etape për sinjalizimin e disa veçorive fonetike, morfologjike e leksikore, të bërë fillimisht po nga këta autorë të huaj.

Po, gjithësesi se duhet të nënvizojmë mendimin mbizotërues të mbështetur nga shumë autorë, në këtë aspekt, se studuesve të huaj u mungoi njohja më e gjerë e gjuhës shqipe në përgjithësi, ngase një numër sosh, si për shembull, Erdeljanoviç, etninë tonë e përkufizoi edhe si serbë të Maqedonisë (“Makedonski serbi”, 1920). Por në mënyrë të veçantë u mungoi edhe njohja e të folmeve popullore që herë-herë ata i patën për objekte të studimeve, këtë do ta nënvizojë edhe M. Begolli kur do të bëjë fjalë për të folmen e

<sup>1</sup>Ajeti, Idriz: “Studime Gjuhësore në Fushën të Shqipes”, I, Prishtinë, “Rilindja”, 1989, f. 19.

<sup>2</sup>C. Tagliavini: “Studimegjuhësore” I (dialektologji) *Të folmet shqipe të tipit të gegërishtes verilindore*, IAP, Prishtinë, 1978, f. 139.

<sup>3</sup>Beci, B. “Mbikëtimet rinovacione fonetike të të folmeve të Gegërishtes Mesme”, “Konf. e parë e Studimeve Albanologjike”, 15-21 nëntor 1962, Tiranë, 1965, f. 261.

<sup>4</sup>Tagliavini, C. “Le parlate albanesi di tipo glego orientale [Dardania e Macedonia nord occidentale]”: në „La terra albanese redenta”, “Kosovo”, Roma, 1942, f.19-80.

<sup>5</sup>Beci, Bahri: “Të folmet qendrore të gegërishtes”, DSH, V, Tiranë, 1987, f. 7.

<sup>6</sup>Lambertz, M. “Albanische Lesebuch” I, Teil, Grammatik und albanische Texte, Leipzig, 1948.

<sup>7</sup>Badallaj, Imri: “E folmja e Hasit”, Prishtinë, 2001, f. 186.

Rugovës në revistën “Përparimi” (1958). Megjithëkëtë, ashtu siç e theksuam edhe më lart se “fillet do t’i gjejmë te dijetarët e huaj që e kanë bërë këtë punë, ose rastësisht, ose me qëllime krejt të tjera, nga ai i studimit të të shqipes dhe dialekteve të saj, do të shprehet Bahri Beci, kur bën fjalë gjatë zhvillimeve të hulumtimeve gjuhësore në krahinën e Matit të Republikës së Shqipërisë<sup>1</sup>.

Në këtë aspekt edhe ato pak përpjekje që janë bërë nuk kanë pasur bazë të shëndoshë dialektore, gjegjësisht kanë qenë të mbështetura në shënime, të cilat kanë qenë të mbështetura në kërkime të bëra me rastin e ndonjë udhëtimit, pastaj nga folklori popullor e aty këtu edhe nga autorët e vjetër të letërsisë sonë. Pasaktësia e këtyre të dhënave të mbledhura do të bëjë që edhe shqipen e Fjalorit të Kujunxhiçit ta konsiderojnë si shqipe të Gjakovës edhe gjuhëtarë të njohur, madje edhe albanologë të shquar si Jokli, Çabej, Taljiavini etj. Gjithashtu duke mos iu ndarë edhe mendimit se studimi i strukturës së shqipes nga disa dijetarë sllavë të kohës bëhej për të sjellëme qëllim pohime e mendime të shtrebuara për historinë e gjuhës shqipe, kryesisht hegjemoniste, si: M. Pavloviq e G. Elezoviqi, etj.<sup>2</sup>

Madje, jo vetëm ky i fundit, i cili do të shkojë edhe më larg duke “zbuluar” se shqiptarët na paskan ardhur në Kosovë dhe në Maqedoninë Perëndimore vetëm pas shekullit XVII, sepse këndej nuk paska emra shqip. Mendime këto që u hodhën në mënyrë të argumentuar nga shkencëtarë shqiptarë dhe shkencëtarë tanë që në Kuvendin e Parë të studimeve Ilire, do të konstatojë E.Çabej, pikërisht për problemin e vendit të formimit të gjuhës shqipe në këtë kontekst<sup>3</sup>.

Të dhënat dialektore e përforcojnë edhe më shumë autoktoninë e elementit shqiptar që në kohën e hershme, në gjithë tërësinë etnografike shqipfolëse bashkëme varietetet e të folmeve të qytetit të Prizrenit dhe rrethinës së tij: *Gjonaj, Marash, Sharr, Lumbardh, Therrandë* duke i dhënë bazë shkencore identifikimit të toponimisë autoktone të natyrës shqipe<sup>4</sup>: *Naisus– Nishi, Scupi-Shkupi, Ulpiana-Lipjani etj.*

Përkundër rezultateve edhe sot e kësaj dite nuk reshtin “qarqe e shkencëtarë të mirëfilltë”, që shqipen dhe shqiptarët të mos i pranojnë si vazhdues të mirëfilltë të ilirëve dhe të shqipes si pasuese të ilirishtes, madje në nivel akademikësh veçohen: M. Garashanini, F. Papazogullu, V. Popoviç etj., duke mos e përfillur fare as realitetin e elementit autokton, as metodologjinë shkencore, po në këtë kontekst as mjete e forma vrastare: “... në një rruginë të errët të Zagrebit vranë me purtekë të hekurt dijetarin jugosllav, Milan Shuflain...” do të shtojë korifeu i letrave shqipe, Ismail Kadare, për *viktimën e apetiteve serbo-hegjemoniste*.<sup>5</sup>

Në prag të Luftës së fundit në Kosovë, po në këtë aspekt nga “shkenca” e ASHA-së serbe, për “multietnicitetin” e qytetit tonë, S. C. Nikoliq do të dalë me të dhëna irrituese e shovene se qytetin e Prizrenit e përbëjnë banorët e besimit muslimanë: turqit, sërëbët e muslimanizuar dhe shqiptarët, derisa të krishterët: sërëbët, grekët, vlllehët, shqiptarët etj. paskan qenë pakicë!<sup>6</sup>

Përballë gjithë këtyre sfidave të jetës studimet dialektologjike kanë shënuar rezultatenga reflektimimë shterues i të cilave padyshim se është *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe* (ADGJSH), ndërsa në këtë rezultat të kësaj pune shumëvjeçare, gjithsesi sështë edhe kjo trevë pjesë e pandarë në paraqitjen e shtatëqind hartave të përpunuara me aspekte të përimitit të çështjeve më të prekshme gjuhësore<sup>7</sup>.

<sup>1</sup>Beci Bahri: “Hulumtime gjuhësore në Mat”, BUSHSSSH, nr. 2, 1962, dhe 2, 1963, f. 29.

<sup>2</sup>Ajeti, I. “Mendime të studiuesve jugosllavë për historinë e gjuhës shqipe”, GJA, 20-90, Prishtinë, 1991, f. 13.

<sup>3</sup>Çabej, E. “Problemi i vendit të formimit të gjuhës shqipe”, “Kuvendi i parë i st. Ilire”, II, Tiranë, 1972, f. 7.

<sup>4</sup>Çabej, E. “Problemi i autoktonisë së shqiptarëve ë dritën e emrave të vendeve”, BUSHT, Tiranë, II, 1958.

<sup>5</sup>Ismajli, R. “Dr. M. Shuflay – viktimë e apetiteve hegjemoniste”, “Bota e re”, nr. 36, Prishtinë.

<sup>6</sup>Serafim S. Nikoliq: “Prizren od srednjogveka do savremenogdoba”, ASHAS, Prizren, 1998, f. 430.

<sup>7</sup>Shkurtaj, GJ. “Dialektet e shqipes”, Tiranë, 2012, f. 163.

## **Përfundime**

Takimet e popujve, jo gjithmonë kanë qenë të dëshirueshme dhe të mirëpritura. Toponimia si dhe atroponimia e arealeve të qytetit të Prizrenit dhe rrethinës së tij i përket në mënyrë të drejtperdrejtë shtrirjes së Dardanisë së lashtë, ndërsa vetë kjo hapësirë pasqyron poashtu në mënyrë të drejtpërdrejtë Zonën Jugore të Ilirikut, pra Ilirisë e që si rrjedhojë e përgjithshme e kësaj hyn në kuadër të antroponimisë ilire nga edhe shquan origjinën ilire të vetë fisit të dardanëve. Në arealet e të folmeve të qytetit të Prizrenit dhe rrethinës së tij, ashtu sikurse edhe në të folmet e tjera të arealeve të të folmeve të Kosovës dhe më gjërë, ka edhe një numër të vogël të bashkësive gjuhësore që edhe sot në përdorim të tyre gjuhësor e kanë gjuhën e folur turke, pra turqishten, përkatësisht boshnjakishten (serbishten). Bashkësi të këtyllë gjuhësore ka në vetë arealin e së folmes së qytetit të Prizrenit si dhe në rrethinë.

Lidhur me kontributin e albanologëve të huaj për gjuhën shqipe në faqet e këtij vështrimi të shkurtër që kemi renditur shquajmë se gjuhësia shqiptare për sa i përket aspektit të studimit të dialekteve të shqipes, në këtë kuadër edhe të të folmeve verilidore të dialektit të veriut, ku bëjnë pjesë edhe të folmet e Prizrenit me rrethinë ka rezultate të rëndësishme. Hapat e parë në njohjen e studimin e lëndës së dialektologjisë shqiptare fillojnë qysh në mesin e shekullit XIX, në këtë kontakt edhe të të qytetit të Prizrenit dhe rrethinës janë të gjuhëtarëve të huaj, si: N. Jokli, S. Mladenov, G. Weigand, H. Pedersen, M. Lambreci, C. Tagliavini, H. Bariq etj.

Në këtë aspekt edhe ato pak përpjekje që janë bërë nuk kanë pasur bazë të shëndoshë dialektore ngase kanë qenë të mbështetura në kërkime të bëra me rastin e ndonjë udhëtimit, nga folklori popullor e aty këtu edhe nga autorët të vjetër të letërsisë sonë. Këto të dhëna do të bëjnë që edhe albanologë të shquar, si: Jokli, Çabej e Taljiavini të jenë të pasaktë në pasqyrimin e shembujve të marrë nga Fjalori i Kujunxhiqit. Studimi i strukturës së gjuhës shqipe nga disa dijetarë sllavë të kohës është bërë me qëllim që të sjellin pohime e mendime të shtrembëruara për historinë e gjuhës shqipe, kryesisht në funksion të qëllimeve hegjemoniste, si: M. Pavloviq e G. Elezoviqi etj.

Tiparet e përafërta dialektore që shquhen në sistemin fonetik, fonologjik dhe atë gramatikor të këtyre të folmeve të Prizrenit dhe rrethinës me të folmet fqinje me gjithë veçoritë e tyre kryesore, konsiderojmë se janë rezultat i kontakteve të gjata të folësve të kësaj treve, natyrisht duke mos i përjashtuar aty këtu edhe ndikimet specifike në të folmet periferike e sidomos të atyre kalimtare, si psh. nga e folmja e Lumës e ajo e Rahovecit etj.

## **Literatura:**

Ajeti, I. "Vepra", ASHAK, I, Prishtinë, 1997.

Ajeti, I. "Mendime të studiuesve jugosllavë për historinë e gjuhës shqipe", GJA, 20-90, Prishtinë, 1991, f. 13.

Agani, H. : *Cila është treva gjuhësore e Fjalorit të L. Kujunxhiqit*, I, II, "GJASSHF", 1, 2 1969, Prishtinë.

Beci, Bahri: "Të folmet qendrore të gegërishtes", DSH, V, Tiranë, 1987.

Beci, Beci: *Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe sistemi fonetik i së folmes së Shkodrës*, Tiranë, 1995.

Beci, Beci: « Mbikaterinovacione fonetiket e të folmeve të Gegërisës së Mesme », « Konf. e parë e Studimeve Albanologjike », 15-21 nëntor 1962, Tiranë, 1965.

Badallaj Imri: "E folmja e Hasit", Prishtinë, 2001.

Badallaj, I. "Disa veçori fonetike të së folmes së Zhurit", GJASSHF, Prishtinë, 1976.

Badallaj Imri: "Problemet e objektit dhe metodës në studimin e dialektologjisë", "Filologji", nr. I, Prishtinë, 1996.

- Bardhi, Medi: “Disa veçori karakteristike në vokalizimin e së folmes së Hasit” SGJ, II, (Dilektologji), Prishtinë, 1979.
- Blaku, Murat: “Ndikimi i shqipes mbi të folmen serbe të Kosovës”, GJASSHF, 23-1993, Prishtinë, 1994. 24-1994, Prishtinë 1995.
- Çabej, E.” Problemi i vendit të formimit të gjuhës shqipe”, “Kuvendi.. Ilire”, II, Tiranë,1972.
- Çabej, E. ”Problemi i autoktonisë së shqiptarëve ë dritën e emrave të vendeve”, BUSHT, Tiranë, II, 1958.
- Dulaj, Fridrik: *E folmja e Rahovecit me rrethinë*, IAP, Prishtinë, 2016.
- Gosturani, Xheladin. *Dr. Hilmi Agani, Fjalori i Lubomir Kujunxhiçit, Prishtinë, 1981, f. 380*, “Studime Filologjike”, nr. 4, 1988, Tiranë.
- Hamp, P. ERIC: “Kukës and Prizren”-Prishtina, GJASSHF, 15, 1985, Prishtinë, 1987
- Halimi, M. ”E folmja e Kabashit të Prizrenit”, ”Kërkime. Dialektologjike.”, Prishtinë,.1985.
- PajazitiNaser: “E folmja e Anadrinit”, Prishtinë, 2008.
- Serafim S. Nikoliq: “Prizren od srednjogveka do savremenogdoba”, ASHAS, Prizren, 1998.
- Shkurtaç, GJ. ”Dialektet e shqipes”, Tiranë, 2012.
- Shkurtaç, GJ. “Shqipja e sotme”, SHBU, U.F.O Pres, Tiranë, tetor 2010.
- Topçiu, Vediha:“Veçoritë fonetike të së folmes së elemntit katolik të qytetit të Prizrenit“, Punim i mbrojtur i Magjistraturës në FF të UP në Degën e Gjuhës shqipe, Prishtinë, 1988.
- Topalli, Mehmet:“Sistemi fonetik i të folmes shqipe të qytetit të Prizrenit”, FF i UP, Dega e Gjuhës shqipe, Prishtinë, 1980.
- Zymberi, Abdullah: “Sistemi foljor në të folmen e fshatit Struzhë të Malësisë së Prizrenit, ”SNGJLKSH, 2. Prishtinë, 1978.
- Zymberi, Abdullah: “Fjalor i fjalëve të rralla”, Prishtinë, 1979;
- Zymberi, Abdullah: “Fjalor popullor: me rreth 20000 fjalë”, “Grafbeni”, Prishtinë, 2014.